

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ бр.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 144, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e aftit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-328/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-365/7 datë 30.01.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 3-të mbajtur më 29.01.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, për shkak se drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) nuk dorëzoi sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonuesve(parapaguesve) të tij, që është në kundërshtim me nenin 144, paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV).

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-328/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, përkatësisht drejtuar Agjencisë të dorëzoi sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonentëve të tij.

3. Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, vepron sipas aktvendimit për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik.

4. Derisa subjekti i mbikëqyrjes i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, përkatësisht vazhdon të kryen shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

5. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6, paragrafi (1), nënparagrafi 4 të LSHMAAV, ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer cënimi ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV ose dispozitave miratuar në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve audiovizuale me kërkesë, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia me datë 21.01.2025, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative mbi përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në nenin 144, paragrafi (3) të LSHMAAV, sipas të cilave operatorët që ritransmetojnë shërbime programore janë të detyruar që sinjalin dalës me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonuesve, në kontinuitet t'i dorëzojnë në lokacionin për grumbullimin e

sinjaleve që ndodhen në secilin zonë në nivel rajonal në pajtim me nenin 62, paragrafi (4) të LSHMAAV, për distribumin e mëtejshëm të programit në sistemin për mbikëqyrje programore të Agjencisë në Shkup. Gjatë mbikëqyrjes së kryer Agjencia ka konstatuar se Shoqëria për prodhim, tregti, hotelieri, transport dhe shërbime MULTIMEDIJA NETWORK L SHPKNJP eksport-import Gostivar, sipas njoftimit të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të ushtroj veprimtari në teritorrin e komunës së Gostivarit, Vrapçishtë, Bogovinë dhe Kërçovë, ku drejtuar Agjencisë nuk dorëzoj sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonentëve(parapaguesve) të tij, që është në kundërshtim me nenin 144, paragrafi (3) të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-328/1 datë 23.01.2025, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 144, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-328/1 datë 23.01.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-365/7 datë 30.01.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV paraqitur në pikën 1. të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim me të cilin ndaj subjektit të paraqitur ndërmerret masë vërejtje publike dhe detyrohet që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që drejtuar Agjencisë të dorëzoj sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonuesve të tij

Agjencia do të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë veproj sipas urdhëresës, përkatësisht sipa vërejtjes publike dhe nëse ndaj Agjencisë dorëzoj sinjal me përmbajtje të njëjtë me atë që është në dispozicion të abonuesve të tij.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për fillimin e kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-328/1 datë 23.01.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për fillimin e kontesti administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontesti administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.